

Në bazë të nenit 8 dhe neni 18 paragrafi 1 alineja 12 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 1 32/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/1 9 dhe „Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë se Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), e në lidhje me nenin 20 paragrafi 1 alineja 10 e Ligjit të njëjtë dhe neni 16 paragrafi 1 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i spastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, në pajtim me Konkluzionin nr.02-3436/2 nga 16.09.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në mbledhjen e 35-të të mbajtur më datë 16.09.2022 miratoi si vijon:

V E N D I M

1. Lejohet rritja e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, nr.05-3096/1 nga 09.08.2022. Të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme që janë planifikuar sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 rriten për 10.000.000,00 denarë dhe të njëjtën bëhen 143.754.238,00 denarë.

2. Me rritjen nga pika (1) e këtij vendimi sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 10.000.000,00 denarë, janë të dedikuara për:

- pagesën e energjisë së shpenzuar elektrike sipas kontratës ekzistuese, si dhe furnizim i ri publik të cilin Agjencia do ta shpallë në vitin 2022, sepse kontrata e vjetër pritet që të shpenzohet në tërësi. Mjetet e planifikuara me planin financiar të Agjencisë për vitin 2022 në shumë prej 3.000.000,00 denarë nuk do të jenë të mjaftueshme.

3. Sigurimi i mjeteve financiare nga pika (2) e këtij vendimi realizohet duke i ndryshuar pozitat si vijon:

- **Të hyrat e përgjithshme** rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 133.754.238,00 denarë bëhen 143.754.238,00 denarë;
- Zëri kalimtar **Mjetet e tepruara që transferohen na viti i kaluar** rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme nga 49.154.238,00 denarë, bëhen 59.154.238,00 denarë;
- **Shpenzimet e përgjithshme** rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 133.754.238,00 denarë bëhen 143.754.238,00 denarë;
- Zëri **401 - Energjia e harxhuar** rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.500.000,00 denarë bëhet 13.500.000,00 denarë.
- Pozita **401000 – Energjia e harxhuar elektrike** rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.000.000,00 denarë, bëhet 13.000.000,00 denarë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m i

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nevojitet që të bëjë rritje të Planit Financiar të Agjencisë për vitin 2022, me qëllim që të sigurohen mjete për pagesën e shpenzimeve të energjisë elektrike. Së këndejmë çmimi i energjisë elektrike përlllogarit sipas HUPX – çmimi mesatar i energjisë elektrike në tregun e bursës së HUPX për muajin e përlllogarit, den/MWh. Për këtë qëllim nevojiten më shumë mjete financiare prej atyre që janë paraparë në vitin 2022 dhe për këtë arsye propozohet rritje e Planit Financiar për vitin 2022.

Që të sigurohen 10.000.000,00 denarë nevojiten ndryshime në pozitat e Planit të miratuar Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022, si vijon: Zëri kalimtar - Mjetet e tepruara që transferohen na viti i kaluar rriten për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme nga 49.154.238,00 denarë, bëhen 59.154.238,00 denarë. Zëri 401 - Energjia e harxhuar rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.500.000,00 denarë bëhet 13.500.000,00 denarë. Pozita 401000 – Energjia e harxhuar elektrike rritet për 10.000.000,00 denarë dhe në vend të shumës së deritanishme prej 3.000.000,00 denarë, bëhet 13.000.000,00 denarë.

Me rritjen e propozuar të Planit Financiar për vitin 2022, të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme sipas planit, rriten për 10.000.000,00 denarë dhe të njëjtat bëhen 143.754.238,00 denarë,

Sipas të lartpërmendurave, në bazë të nenit 8 dhe neni 18 paragrafi 1 alineja 12 Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/1 dhe 27/19 dhe „Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë se Veriut “ nr.42/20 dhe 77/21), e në lidhje me nenin 20 paragrafi 1 alineja 10 nga Ligji i njëjtë dhe neni 16 paragrafi 1 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i spastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019 , në pajtim me Konkluzionin nr.02-3436/2 nga 16.09.2022 , Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në mbledhjen e 35-të të mbajtur më datë 16.09.2022 miratoi si vendimin si në dispozitiv.

Nr. 05-3457/1
16.09.2022
Shkup

Agjencia për shërbime Mediatike
audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v

Ekzemplar i Vendimit të dorëzohet deri te:

- Drejtori;
- Sektori për Financa dhe Logjistikë;
- Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike;
- Sektori për Përkrahje Informatike dhe Punë të Përgjithshme – Arkivi;